

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROGRAMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE IV”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i Investimeve Sociale IV”.

Ndryshimi i marrëveshjes së huas dhe programit për financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale IV” konsiston në ndryshimin e nenit 3.2 të marrëveshjes, në të cilin përcaktohet afati i fundit i disbursimit të fondeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje, duke shtyrë atë deri me datë 30 tetor 2018, si dhe në zëvendësimin e emërimit “Ministria e Financave”, kudo në tekst, me “Ministra e Financave dhe Ekonomisë”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është përfshirë në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji do të bëjë të mundur shtyrjen deri në datën 30 tetor 2018 të afatit të fundit për disbursimin e fondeve, në kuadër të marrëveshjes së

huas dhe programit, për financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale IV”.

Punimet civile kanë përfunduar për të shtatë objektet (ose 94 km rrugë) si dhe janë kryer të gjitha pagesat, bashkë me garancitë e defekteve. Të gjithë objektet, pas përfundimit të periudhës së garancisë, janë dorëzuar pranë njësive të qeverisjes vendore. Po ashtu, supervizori i punimeve ka përfunduar raportin final, i cili është dërguar pranë KfW-së.

Duke iu referuar kontratës së supervizorit, pagesa përfundimtare e garancisë, me vlerë 5% të kontratës, do të kryhej në fund të periudhës së garancisë së punimeve, apo në dhjetor 2017. Kjo periudhë shkonte përtej afatit të disbursimit të fondeve të huas, i cili ka përfunduar në qershor 2017.

Në këto kushte, u dakordësua me KfW-në shtyrja e afatit të marrëveshjes, në mënyrë që të ekzekutohet edhe pagesa e fundit, për sa sqarohet më sipër. Fillimisht, me KfW-në u dakordësua shtyrja e afatit deri më 30 mars 2018 dhe u procedua me miratimin në parim dhe nënshkrimin e dokumentit përkatës ndryshues. Duke qenë se procesi i aprovimit nga kreditori si dhe i miratimit në parim të ndryshimit nga Këshilli i Ministrave mori një kohë të konsiderueshme, afati deri në 30 mars 2018 nuk mjaftoi për përfundimin e procedurave që parashikon legjislacioni shqiptar për bërjen efektiv të ndryshimit. Për këtë arsye, u diskutua dhe u dakordësua me kreditorin një shtyrje e mëtejshme e afatit, deri më 30 tetor 2018, kohë kjo që do të bënte të mundur bërjen efektiv të dokumentit ndryshues si dhe disbursimin e fondeve të mbetura.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, dhe nenet 17 e 23, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ndryshimi i marrëveshjes së huas dhe programit për financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale IV”, u miratua, në parim, nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet vendimit nr.425, datë 11.7.2018, u nënshkrua ndërmjet palëve dhe po i nënshtrohet procedurës që parashikon kuadri ligjor në fuqi për bërjen efektive të saj, konkretisht procedurës së ratifikimit me ligj.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përafron me ndonjë akt ligjor të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti parashikon propozimin e projektligjit për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas dhe programit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”, sipas tekstit të dokumentit ndryshues, dërguar nga KfW-ja nëpërmjet letrës së saj të datës 30 prill 2018, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Teksti i dokumentit të ndryshimit të marrëveshjes së huas dhe programit i bashkëlidhet këtij projektligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e aktit ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të cilat janë shprehur dakord.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ndryshimi i propozuar i marrëveshjes së huas dhe projektit konsiston vetëm në shtyrjen e afatit të përdorimit të kredisë së akorduar për projektin në fjalë dhe nuk përbën ndonjë ndryshim në shumën apo termat e tjera financiare të kredisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE